

Zhvillohet moduli i III i sesioneve të trajnimit të audituesve të KLSH-së dhe ANAC mbi identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të korrupsionit, 25-27 tetor, 2022

Në kuadër të bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC), u përmyll moduli i III i sesioneve të trajnimit treditur për audituesit e KLSH-së mbi identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, nga perspektiva e auditimit të jashtëm.



Gjatë trajnimit, ekspertët e ANAC prezantuan mjetet se si mund të përshtaten praktikat më të mira ndërkombëtare në kuadrin institucional kombëtar, duke trajtuar edhe disa raste konkrete studimore.



Ky trajnim, ashtu si edhe dy sesionet e mëparshme të realizuara në muajin nëntor 2021 dhe mars 2022, kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të KLSH-së duke promovuar shkëmbimin e përvojave ndërmjet ekspertëve të lartë të ANAC-t dhe KLSH-së.